



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1016/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha edhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesë nga Hazir Raçi kandidat për Asamble Komunale në Podujevë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK), paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të publikimit të Rezultateve Përfundimtare për Asamble Komunale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Hazir Raçit kandidat për Asamble Komunale nga radhët e subjektit politik LDK në Podujevë.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 03.12.2013, ka pranuar një ankesë nga Hazir Raçi, në cilësinë e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal nga radhët e subjektit politik LDK, në Podujevë, me të cilën pretendohet pas mbylljes së kutive ka filluar numërimi i votave dhe aty kam arsye të besojë se ka ndodhur një devijim i madh nga realiteti mesë votave që gjenden në kutit dhe procesverbalet e numërimit po ashtu theksohet se në bazë të votuesve të mi të mundshëm dhe gjendjes faktike në procesverbalet e numërimit është një devijim i madh ku në bazë të numërimit thotë se unë i kam 215 vota ku në bazë të votuesve të mi duhet ti kem mbi 450 vota. Në këto Qendra të Votimit (QV), 1801/5, 1801x/4, 1801e/8, 1801x/3, 1824e/11, 1813e/2, 1814e/2, 1815e/4, 1816e/3, 1822e, 1829e/2, 1832e/2, 1836e, në të gjitha rastet ka kërkuar të bëhet rinumërimi i votave, si dhe ka të bashkangjitura deklaratat e disa dëshmitareve të cilët dëshmojnë se kanë votuar për parashtruesin e ankesës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi nga dëshmitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës se pretendimet ankimore nuk qendrojnë ngase dëshmit e ofruara nuk janë të asaj natyre që do të ndikonin për të marrë ndonjë vendim ndryshe. Pretendimet e tilla PZAP-i i vlerëson si të pabazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse, siç pretendon pala ankuese në ankesën e ti, andaj ankesa e tillë është e pabazuar dhe se për këtë çështje PZAP-i në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe nenit 3.6 pika c të Rregullave dhe Proceduarve të PZAP-it vendosi si në dispozitiv të këtij të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1016/2013 më datën 06.12.2013



Këshillë Juridik:

Ndaj ketij vendimi mund te paraqitni ankese ne Gjykatën Supreme te Republikës se Kosoves Brenda njezetekater (24) oreve nga moment i marrjes se vendimit nga PZAP-i.